



30.09.2020

Staatskanzlei
Zyra për Shtyp
40190 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134 ose 1405
Telefax 0211 837-1144

presse@stk.nrw.de
www.nrw.de

Deklaratë për shtyp - 809/09/2020

Nordrhein-Westfalen zgjat Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi: Rregulloret për tregjet e Krishtlindjeve dhe udhëzimet për festimet private

**Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale ju
komunikon:**

Kabineti i Landit ka vendosur të zgjasë urdhëresat për mbrojtjen nga koronavirusi deri më datë 31 Tetor 2020 (duke e përfshirë këtë datë). Ndër të tjera, ka ndryshime dhe shtesa për tregjet e Krishtlindjeve dhe për festimet private. Rregulloret për tregjet e Krishtlindjeve janë përcaktuar në një aneks të veçantë tek Urdhëresa për Mbrojtjen nga Koronavirusi, duke krijuar si rrjedhim përputhshmëri me ligjin. Festimet private duke filluar me minimumi 50 pjesëmarrës, të cilat zhvillohen për arsye të jashtëzakonshme, jashtë zonave private (për shembull festimet e dasmave), duhen deklaruar paraprakisht tek Ordnungsamt përkatëse.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann: "Incidencat e infeksioneve të ditëve të fundit na kanë treguar se festimet private kanë në veçanti një influencë të konsiderueshme tek shkalla e infeksionit. Ne nuk duam që në një pikë të caktuar të na duhet të përballemi me vendimin për t'i ndaluar tërësisht këto festime. Prandaj duhet të sigurohemi që rregullat të ndiqen gjithashtu në këto raste. Të dhënat e kontaktit janë elementi kryesor për të ndaluar përhapjen e mëtejshme dhe për të ndërprerë zinxhirin e infeksionit."

"Për festimet brenda katër mureve të shtëpisë tuaj vlen mbrojtja e shkallës së lartë e të drejtave thelbësore për privatësinë", Laumann vazhdon: " Këtu zë vend thirrja ime urgjente: Vazhdoni ta merrni

koronavirusin seriozisht, zbatoni rregullat për higjienën dhe për distancimin, mbroni veten tuaj dhe të tjerët! Sa më me përgjegjësi të silllet individi, aq më i madh është efekti për shoqërinë. Muajt e vjeshtës dhe të dimrit do të na prezantojnë me sfida të veçanta për luftimin e pandemisë së koronavirusit."

Rregulloret për tregjet e Krishtlindjeve

Suksesi i tregjeve të Krishtlindjeve gjatë pandemisë varet nga një plan i mirëmenduar higjiene, aksesit dhe mbrojtje nga infeksioni, i cili merr parasysh kushtet përkatëse lokale. Tek tregjet e Krishtlindjeve lejohen gjithashtu tavolinat e larta me hapësira të përcaktuara ku qëndrohet në këmbë, me kushtin që të jenë të veçuara nga rrugët dhe hapësirat ku kalojnë njerëz. Një rregullore identike vlen gjithashtu menjëherë për gastronominë.

Për më tepër dyqanet do të mund të hapen për disa të diela, gjatë dhe direkt pas sezonit të Krishtlindjeve. Kjo mundëson shmangien e rrezikut të infeksionit, shpërndarjen në mënyrë të njëtrajtshme të pazarit të shtunave dhe shmangien e grumbullimit të njerëzve tek qendrat e qyteteve.

Rregulloret për festimet private

Festimet private për arsye të jashtëzakonshme (për shembull festat e dasmave) jashtë ambienteve tuaja private duhet të regjistrohen paraprakisht tek Ordnungsamt përkatëse minimalisht tre ditë pune para se të zhvillohet evenimenti (kur pritët të jenë të pranishëm minimalisht 50 pjesëmarrës). Për më tepër, duhet të emërohet një person përgjegjës për evenimentin. Një listë mysafirësh duhet të paraqitet për evenimentin dhe të përditësohet gjatë tij. E rëndësishme në këtë kontekst është që Ordnungsämter mos të kryejnë procedurë aprovimi, por vetëm regjistrimin. Kjo i lejon autoritetet komunale të kuptojnë cilat festime po zënë vend në komunat përkatëse dhe nëse është e nevojshme të kontrollojnë nëse po zbatohen rregullat e Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi. Vazhdon të jetë i pandryshuar fakti që festime të tilla janë të limituara në maksimumi 150 pjesëmarrës. Për festat të cilat do të zhvillohen në fillim të tetorit, afati i fundit i regjistrimit i nënshtrohet pritshmërisë legjitime. Gjithsesi organizatorët janë të detyruar të regjistrohen për evenimente sa më shpejt të jetë e mundur.

Për më tepër, tek urdhëresa janë implementuar marrëveshjet e vendimit të qeverive të Landeve dhe të qeverisë federale të datës 29 shtator 2020, në lidhje me kufirin maksimal të pjesëmarrësve. Kjo do të thotë se duke filluar nga një incidencë 7 ditore me vlerën 35, festimet në hapësirat publike lejohen vetëm me deri në 50 pjesëmarrës. Kur incidenca kap vlerën 50, ky numër ulet në 25. Përjashtime nga këto kufizime maksimale pjesëmarrësish mund të lejohen në raste individuale kur ekzistojnë plane për higjienën dhe për mbrojtjen nga infeksioni.

Për më tepër qeveritë e Landeve dhe qeveria federale kanë vendosur të ndëshkojnë me gjobë rastet kur janë vendosur të dhëna të gabuara kontakti tek listat të cilat përdoren për qëllime gjurmimi (për shembull në restorante). Në Nordrhein-Westfalen, do të ndëshkohen me një gjobë standarte prej 250 eurosh mysafirët të cilët bejnë këto deklaratatë të pavërteta. Në rastin kur nuk është regjistruar një festë jashtë ambienteve private ku priten të marrin pjesë të paktën 50 veta, do të zbatohet një gjobë prej 500 eurosh.

Nëpërmjet një klauzole inovacioni, do të merren në konsideratë me përparësi sistemet e reja të ajrimit tek planet e higjienës dhe të mbrojtjes nga infeksioni. Nëse inovacionet teknike çertifikohen në mënyrë të verifikueshme dhe të përshtatshme duke i bërë të panevojshme disa masa të tjera mbrojtëse, Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale mund të lejojë përjashtime nga Urdhëresa për Mbrojtjen nga Koronavirusi.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu e gatshme tek www.land.nrw

[Shënim i përgjithshëm në lidhje me mbrojtjen e të dhënave](#)